



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VIII**

***Sesioni pranveror***

**Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim**

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 14.7.2022, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Ganimete Musliu, Ekrem Mustafa, Salih Zyba, Isak Shabani, Samra Ilijazi dhe Jetmira Vrenezi.

Munguan: Besian Mustafa, Albena Reshitaj dhe Zoran Mojsilović.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

*Në këtë mbledhje u propozua ky*

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 8.7.2022;
3. Shqyrtimi i 20 Projektligjeve për harmonizimin me Ligjin për Kundërvajtje nga fusha e bujqësisë;
4. Votimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08-L-154 për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për studimin e fizibilitetit dhe Projektidesë për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë”;
6. Procedimi në grupet punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve;
7. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Ganimete Musliu*, e kundërshtoi rendin e ditës dhe tha se mbledhja është dashtë të thirret me vetëm një pikë, pra për Projektligjin nr. 08-L-154 për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për studimin e fizibilitetit dhe Projektidesë për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë” e cila është urgjente. Ndërsa, propozoi që rendi i ditës të ndryshohet dhe të diskutohet vetëm pika nr. 5 e cila është urgjente, ndërsa pikat e tjera të mbeten për mbledhjen tjetër ashtu siç është paraparë.

*Kryetarja*, tha se e kemi ftuar këtë mbledhje me kërkesën urgjente të Kryetarit të Kuvendit, për shqyrtimin e Projektligjit nr. 08-L-154 për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për studimin e fizibilitetit dhe Projektidesë për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë”, ndërsa i kemi

bartë edhe pikat e tjera të mbledhjes së caktuar për ditën e premtë, për shkak të agjendës së planifikuar të grupeve punuese për ditën e premtë.

*Salih Zyba*, tha se sot mund ta diskutojmë pikën 5 dhe pikën të ndryshme, ndërsa nesër mund të vazhdojmë me pikat e tjera, por që duhet që deputetët të vijnë edhe nesër.

*Isak Shabani*, tha se pasi që është mbledhje urgjente nuk duhet të ketë pikë të ndryshme.

*Në fund me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, komisioni e miratoi rendin e ditës me ndryshimet e propozuara, ku do të diskutohet vetëm pika e 5, ndërsa pikat e tjera të barten në mbledhjen e radhës që do të mbahet të premten më 15.7.2022.*

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08-L-154 për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për studimin e fizibilitetit dhe Projektidesë për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë”.**

*Fitore Dalipi-Pacolli, kryetare*, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08-L-154 për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për studimin e fizibilitetit dhe Projektidesë për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë”, dhe tha se i plotëson kushtet e parapara në nenet 54 dhe 60 të Rregullores së Kuvendit dhe ia rekomandojmë Kuvendit për miratim.

*Ganimete Musliu*, tha se për shkak të rëndësisë që ka kjo marrëveshje, Grupi parlamentar i PDK-së i jep përkrahje në komision dhe në seancë.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetarja ftoi për votim dhe konstatoi se me 8 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:*

### *Rekomandim*

*Të miratohet Projektligji 08-L-154 për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për studimin e fizibilitetit dhe Projektidesë për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë.*

*Kryetarja*, për shkak të rëndësisë që ka ky Projektligj, në pajtim më nenin 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, propozoi amendamentimin e rendit të ditës të seancës plenare, më 14 korrik 2022.

*“Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08-L-154 për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për studimin e fizibilitetit dhe Projektidesë për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë” të bëhet me shmangie nga afatet procedurale të parapara më nenin 15, paragrafi 7 të dhe nenin 56, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit. “*

*Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetarja ftoi për votim dhe konstatoi se me 8 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë:*

*Propozimin për amendamentimin e rendit të ditës të Seancës plenare, më 14 korrik 2022.*

Mbledhja përfundoi në orën 9:30.

E përgatiti: *Stafi mbështetës i Komisionit.*

***Fitore Pacolli-Dalipi,***

-----  
***Kryetare e Komisionit***